

# Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal Komuna e Mamushës

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



KOMUNA E  
MAMUSHËS

Implementuar nga:  
**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:  
**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



---

# Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal Komuna e Mamushës

Dhjetor 2012

---

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



KOMUNA E  
MAMUSHËS

Implementuar nga:  
**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:  
**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



## Shënim

Ky raport i VSM-ë është përgatitur në mënyrë të pavarur nga konsulenti privat Kadri Tillemann sipas kërkesës së UN-Habitat-it sipas kushteve dhe afateve të kontratës relevante individuale. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk janë doemos pikëpamje të UN-Habitat-it apo Komunës së Mamushës. Konsulenti privat nuk e merr përgjegjësinë e vendimit apo masave të ndërmarra mbi bazë të sugjerimeve dhe përmbytjes së këtij raporti.

### Informatat kontaktuese:

UN-Habitat Zyra në Prishtinë  
Ndërtesa e Ministrive “Rilindja” Kati i 10të  
1000 Prishtinë Kosovë  
Tel + 381 38 20032611  
E-mail: [info@unhabitat-kosovo.org](mailto:info@unhabitat-kosovo.org)

Komuna e Mamushës  
Ueb faqja e Komunës: <http://kk.rks-gov.net/mamushe/>  
Tel: + 381 38029 283 260

Kadri Tillemann  
Konsulent Privat  
Tel + 372 50 15 440  
E-mail: [kadri.tillemann@vesterra.ee](mailto:kadri.tillemann@vesterra.ee)

# TABELA E PËRMBAJTJES

Shënim.....	1
<b>I. LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>4</b>
<b>II. PËRMBLEDHJE JO – TEKNIKE.....</b>	<b>5</b>
<b>III. HISTORIKU.....</b>	<b>7</b>
3.1 METODOLOGJIA E VSM-së .....	7
3.2 PALËT KONSULTUESE .....	8
3.3 AFATI KOHOR .....	8
<b>IV. PËRMBLEDHJE E ELEMENTEVE TË PZHK-së SË MAMUSHËS .....</b>	<b>9</b>
<b>V. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR, PLANET E TJERA, PROGRAMET, KONVENTAT DHE PROTOKOLLET .....</b>	<b>11</b>
5.1 DIREKTIVA e BE-së PËR VSM-së.....	11
5.2 DIREKTIVAT TJERA TË BE-së.....	12
5.3 STRATEGJIA 2020 E BE-së .....	13
5.4 OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË MIJËVJECARIT TË KB-së .....	13
5.5 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE VSM NË KOSOVË .....	14
5.5.1 INFORMATA LIDHUR ME HISTORIKUN E KOSOVËS .....	14
5.5.2 HISTORIKU LEGJISLATIV KOMBËTAR .....	14
5.6 PLANET DHE PROGRAMET TJERA RELEVANTE.....	16
5.6.1 ANALIZA MJEDISORE E VENDIT TË KOSOVËS. VLERËSIMI I SHPENZIMEVE TË DEGRADIMIT MJEDISOR, SHQYRTIMI INSTITUCIONAL DHE SHQYRTIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE LIDHUR ME MJEDISIN .....	16
5.6.2 STRATEGJIA QEVERITARE PËR MENAXHIMIN E ,MBETURINAVE 2011 – 2020 .....	16
5.6.3 STRATEGJIA QEVERITARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITETIN 2011 -2020 .....	17
5.6.4 OPSIONET E QËNDRUESHME ENERGJETIKE PËR KOSOVËN. ANALIZË E MUNDËSISË SË SIGURIMIT TË BURIMEVE DHE KOSTOJA E TYRE .....	17
5.6.5 PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS 2010-2020 +.....	18

<b>VI. INFORMACIONET THEMELORE MBI MJEDISIN</b> .....	19
6.1 POPULLSIA .....	20
6.2 BIODIVERZITETI, FLORA DHE FAUNA .....	21
6.3 PËRDORIMI I TOKËS .....	21
6.4 FATKEQËSITË NATYRORE .....	25
6.5 UJI .....	27
6.6 AJRI DHE KLIMA .....	27
6.7 TOKA.....	28
6.8 MANGËSITË E IDENTIFIKUARA TË TË DHËNAVE .....	28
<b>VII. OBJEKTIVAT MJEDISORE, TREGUESIT DHE SYNIMET</b> .....	32
<b>VIII. VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE TE PZHK-së</b> .....	34
8.1 VLERËSIMI I ALTERNATIVAVE MJEDISORE .....	35
8.2 MASAT LEHTËSUESE .....	37
<b>IX. MONITORIMI</b> .....	39
<b>X. REFERENCAT</b> .....	40
<b>XI. ANEKSET</b> .....	42

#### LISTA E HARTAVE

Harta IV.1 Skenari i preferuar për zhvillimin e komunës në të ardhmen .....	10
Harta 6.3.1Përdorimi i tokës në Mamushë .....	22
Harta 6.3.2 Struktura e parcelave në Mamushë.....	24
Harta 6.4.1 Rreziku nga erozioni i tokës.....	26

## I. LISTA E SHKURTESAVE

KE	Komisioni Evropian
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
BE	Bashkimi Evropian
GDP	Prodhimi Bruto Vendor
KEAP	Plani i Veprimit i Kosovës për Mjedisin
SKM	Strategjia Kosovare e Mjedisit
SKZhp	Strategjia Kosovare e Zhvillimit dhe Plani
LPH	Ligji mbi Planifikim Hapësinor
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PP-të	Planet dhe Programet
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
OSM	Objektivat Strategjike Mjedisore
NP	Ndërmarrjet e Publike
ATBNZh	Agjencioni Turk për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim
KB	Kombet e Bashkuara
KEEKB	Komisioni Ekonomik për Evropë i Kombeve të Bashkuara
UN-Habitat	Programi për Vendbanimet Njerëzore i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## II. PËRMBLEDHJE JO – TEKNIKE

Raporti aktual i vlerësimit strategjik mjedisor është i përgatitur si një dokument vendimtar i procesit të VSM-së për Planin Zhvillimor të Komunës së Mamushës. Raporti është rezultati kryesor i VSM-së dhe nënvizon të gjeturat e procesit të vlerësimit. PZHK-ja është dokument ligjor i përgatitur në emër të autoriteteve komunale të Mamushës me mbështetje të ofruar nga UN-Habitat-i në Kosovë. Gjithashtu kërkohet me ligj që ndikimet perspektive mjedisore nga PZHK-të duhet të vlerësohen gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

Direktiva Evropiane mbi VSM-të (2001/42/EC) ishte miratuar në legjislacionin e Kosovës në Ligjin e Kosovës për Vlerësim Strategjik Mjedisor në vitin 2010. Sipas ligjit „qëllimi i VSM-së është që të siguroj që gjatë përgaditjeve dhe para miratimit të disa planeve dhe programeve që pasojat mjedisore janë identifikuar dhe vlerësuar”. Planet zhvillimore komunale janë në mesin e dokumenteve për të cilat kërkohet me ligj kryerja VSM-së. Prandaj procesi i shqyrtimit për të vlerësuar nëse plani është subjekt i VSM-së nuk është kryer në kuadër të vlerësimit aktual. Legjislacioni i VSM-së i Kosovës ndjek parimin e përgjithshëm se procesi i VSM-së duhet të kryhet paralelisht me procesin e përgatitjes së planit të vlerësuar dhe duhet të finalizohet para miratimit të planit në mënyrë që të përfshijë ndryshimet e nevojshme apo korrigjimet në plan. Prandaj procedura e vlerësimit ka filluar në fazën e hershme të përgatitjes së planit në janar të vitit 2012. Para vlerësimit, ishte bërë rishikimi i metodologjisë dhe literaturës. Faza e parë e vlerësimit ishte procesi i studimit së bashku me rezultatin e raportit të studimit. Studimi u pasua nga procesi i vlerësimit i të gjithë kapitujve të PZHK-së, procesi i VSM-së ka përfunduar me përgatitjen e draftit të raportit të VSM-së në nëntor të vitit 2012. Procedurat e konsultimit dhe publikimit të raportit të PZHK-së dhe VSM-së ishin planifikuar të mbaheshin në dhjetor të vitit 2012. Synimi i përgjithshëm i procesit të VSM-së ishte që të organizojë atë në mënyrë sa më të hapur që është e mundur dhe të përfshijë të gjitha palët e nevojshme. Përveç procesit të shqyrtimit publik që kërkohet me ligj, ka pasur edhe aktivitete përfshirëse në fazën e studimit të VSM-së. Në stadin e fundit të përgatitjes së raportit të studimit, diskutimi publik u mbajt në Mamushë për të prezantuar esencën dhe rezultatet e para të procesit të VSM-së, si dhe për të punuar së bashku në identifikimin e objektivave dhe indikatorëve të përshtatshme të VSM-së për Mamushën. Procesi përfshinte bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale të Mamushës - ata ishin burime të rëndësishme të informatave që kanë të bëjnë me mjedisin. Përveç ngritjes së kapaciteteve u zhvilluan edhe trajnime dhe diskutimet me stafin komunal. Fakti që VSM-ja është çështje e re dhe mjaft komplekse e bën të vështirë për të tërhequr publikun e gjerë për t'u përfshirë në mënyrë aktive në këtë proces. Në mënyrë që të bëjmë çështjet mjedisore të kuptueshme dhe të nxisim pjesëmarrje të gjerë në procesin e VSM-së ekziston nevoja jetike për të zgjedhur komunikim të përshtatshëm dhe efektiv si dhe masa përfshirëse.

Raporti i studimit përfshin analizat paraprake të planeve dhe programeve tjera nga nivelet e ndryshme të qeverisë (ndërkombëtare, kombëtare, lokale, nën-lokale) dhe mbledhja e të dhënave bazike mjedisore. Sipas informatave të mbledhura ka pasur një numër më të theksuar të çështjeve sfiduese mjedisore të tilla si përdorimi i ekuilibruar i tokës bujqësore, problemet e qëndrueshme të bujqësisë dhe ndotjes. Brenda fazës së studimit të VSM-së janë zgjedhur tre alternativa mjedisore për tu analizuar më tej gjatë fazës së vlerësimit – skenari zero / skenari mos bëj asgjë, zbatimi i plotë i skenarit të integruar/preferuar të PZHK-së dhe skenari i kombinuar (skenari i integruar me elemente shtesë). Lista e objektivave mjedisore, objektivave dhe treguesve (OSM-së) është përgatitur edhe gjatë fazës së studimit në mënyrë që të parashikojnë ndikimet, dhe të përshkruaj dhe monitoroj ndryshimin e PZHK-së së Mamushës në mjedis.

Gjatë fazës së vlerësimit është vlerësuar se si zbatimi i planit zhvillimor komunal të Mamushës do të ndikoj në situatën mjedisore dhe se cilat aspekte duhet të konsiderohen deri sa plani të zbatohet në mënyrë që të minimizohet rreziku potencial mjedisor. Potenciali kryesor i zhvillimit të Mamushës është identifikuar të jetë përdorimi i vazhdueshëm i tokës bujqësore. Prandaj përdorimi i balancuar i tokës dhe bujqësia e qëndrueshme janë faktorët kyç për të ruajtur dhe për të përmirësuar cilësinë e mjedisit jetësor në Mamushë. Kjo mund të vlerësohet se PZHK-ja aktuale në mënyrë efektive trajton këtë aspekt dhe propozon ndarjen adekuate të burimeve të tokës në mes të zonave bujqësore, natyrore dhe zonave të banimit. Korniza hapësinore e planit synon ruajtjen e dheut të kualitetit të lartë për bujqësi. Në të njëjtën kohë mundohet të plotësojë kërkesat e popullatës në rritje nëpërmjet dendësimit dhe zgjerimit të moderuar. Në këtë mënyrë plani mbron modelet e balancuara të përdorimit të tokës, si dhe shmang dhe zbut efektet e mundshme negative mjedisore. Ndërsa çështja e përdorimit të tokës mund dhe duhet të trajtohet në nivel lokal, problemi tjetër kompleks dhe jetik mjedisor - ndotja – për këtë nevojitet vëmendja lokale dhe kombëtare. Mamusha kryesisht ballafaqohet nga burimet që nuk kanë vend të caktuar të ndotjes si nga bujqësia ( plehrat, pesticidet) mbeturinat e

ngurta (kryesisht ato shtëpiake) dhe ato kërcënojnë të dy, kualitetin e dheut dhe burimet e ujit dhe kanë ndikim indirekt në humbjen e biodiversitetit dhe në përgjithësi degradimin e mjedisit. Plani parashikon disa masa për të adresuar këto probleme (promovimi i kompostimit, impiantet për trajtimin e ujërave të zeza, stacione tranzite për mbeturinat), por në mënyrë që të zgjidhim problemet në mënyrë efektive ekziston nevoja për mekanizmat e koordinimit kombëtar/ndërkombëtar dhe financim.

Konkludimi i përgjithshëm i VSM-së është ajo se plani zhvillimor është i drejtuar në përmirësimin e situatës aktuale, ekonomike si dhe mjedisore. Aktivitetet dhe komponentët e planit nuk përfshijnë çfarëdo ndikime madhore negative në mjedis. Në të kundërtën, është analizuar se nëse plani aktual nuk do të zbatohet është e mundshme që situata mjedisore do të vazhdoj të përkeqësohet. Matrica mjedisore reflekton atë se vetëm disa nga projektet zbatuese mund të kishin ndikim negativ të vogël apo të moderuar mjedisor. Këto kryesisht janë projekte ndërtimore për të përmirësuar infrastrukturën sociale dhe teknike të Mamushës dhe nëse masat e propozuara lehtësuese do të zbatoheshin, ato nuk paraqesin ndonjë kërcënim të konsiderueshëm për mjedisin.



# III. HISTORIKU

## 3.1 METODOLOGJIA E VSM-së

“VSM-ja, si proces sistematik për vlerësimin e pasojave mjedisore të politikave të propozuara, planeve dhe iniciativave të programeve në mënyrë që të siguroj që ato të jenë plotësisht të përfshira dhe të adresuara në mënyrë të drejt në fazat e duhura të mëhershme të vendimmarrjes në të njëjtin nivel me konsideratat ekonomike dhe sociale” (Sadler & Verheem, 1996) është një mjet kompleks dhe duhet të përdoret me një përshtatje të duhur dhe me një metodologji të përshtatshme për planin apo programin e veçantë që VSM-ja e adreson. Gjatë viteve VSM-ja është zbatuar në Evropë dhe kudo tjetër dhe është përdorur për të vlerësuar ndikimet mjedisore të planeve dhe programeve të ndryshme në kushte të ndryshme mjedisore dhe qeveritare. Prandaj grupi i metodave dhe mjeteve të mundshme është i gjerë.

VSM-ja është një proces për të vlerësuar në stadin e duhur të mëhershëm të ndikimit mjedisor, dhe pasojat, e politikave, planeve apo iniciativave të programeve. Qëllimi i VSM-së është të siguroj që pasojat mjedisore të planeve apo programeve janë adresuar gjatë përgatitjes së tyre dhe para se ato të miratohen përfundimisht. Gjithashtu i jep publikut dhe palëve tjera të interesuara një mundësi që të komentojnë dhe të mbahen të informuar mbi vendimet dhe se si janë bërë ato. VSM-ja shpesh definohet duke përdorur definimin nga Theriueli si “ proces formal, sistematik dhe gjithëpërfshirës për vlerësimin e efekteve të politikave, planeve apo programeve apo alternativave të tyre të propozuara, duke përfshirë edhe raportin në të shkruar mbi të gjeturat e atij vlerësimi, dhe përdorimi i të gjeturave në vendim-marrjen llogaridhënëse publike” (Therivel et al 1992).

Direktiva Evropiane mbi VSM-në (2001/42/EC, më tej e përshkruar në kapitullin 3.1) ishte e marrë në legjislacionin e Kosovës nga Ligji Kosovar për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë në vitin 2010. Sipas ligjit, “ qëllimi i ligjit mbi VSM-në është që të siguroj se pasojat mjedisore të disa planeve dhe programeve të caktuara janë identifikuar dhe vlerësuar gjatë përgatitjes së tyre dhe para miratimit të tyre. Disa plane dhe programe të përgatitura nga organet e njohura me ligj dhe të cilat duket se do të kenë një ndikim të domethënë në mjedis tani do të kërkojnë t’ju kryhet një VSM-ë, ku përgatitja e planeve dhe programeve të tilla ka filluar pas asaj date”.

Pasi që në rastin e PZHK-së së Mamushës nuk ka nevojë të përcaktohet nëse ky plan është subjekt i VSM-së, metodologjia aktuale nuk përfshin analizim të mëtejshëm lidhur me procedurat e ekzaminimit. Për këtë arsye stadi kryesor i procedurave aktuale të VSM-së është:

- studimi. Një proces i studimit është që të themeloh përmbajtjen e VSM-së, kriteret relevante për vlerësim (qëllimet mjedisore, treguesit e synimit si dhe alternativat mjedisore). Këto janë të vendosura në raportin e studimit. Krijimi i raportit të studimit si i tillë nuk kërkohet as nga Direktiva e as nga legjislacioni kombëtar në rastin e Kosovës. Në disa shtete anëtare është kërkesë ligjore që raportet e studimit të hartohen dhe të publikohen, mirëpo ka edhe prej tyre që nuk kanë nevojë për obligime të tilla. Megjithatë, në praktikë, duket sikur në shumë raste dokumenti i studimit është krijuar në baza vullnetare. Në rastin e VSM-ë së PZHK-së së Mamushës, një raport i ndarë i studimit ( Aneksi 1) ishte përgatitur.

- grumbullimi i të dhënave themelore. Sipas OBEZ-it (2006) “VSM-ja duhet të jetë e bazuar në një kuptimin e mjedisit të prekur dhe sistemeve sociale. Kjo duhet të përfshijë më shumë se një inventar të thjeshtë, p.sh. rregjistrimi i florës, faunës, peizazhit dhe mjedisit urban. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet sistemeve të rëndësishme ekologjike dhe shërbimeve, elasticitetit dhe dobësisë së tyre, dhe rëndësisë për mirëqenien e njeriut. Masat mbrojtëse ekzistuese mjedisore dhe/apo qëllimet të caktuara në instrumentet legjislative ndërkombëtare, kombëtare apo rajonale duhet të rishikohen. Të dhënat themelore duhet të reflektojnë qëllimet dhe treguesit e identifikuar në “raportin e studimit”. Për planet hapësinore, të dhënat themelore mund të përfshijnë në mënyrë të dobishme stokun e aseteve natyrore përfshi edhe fushat e ndjeshme, vendbanimet kritike, dhe komponentët e vlefshme të ekosistemit”.

- identifikimi i alternativave, analiza e ndikimeve potenciale. Është karakteristike se legjislacioni kombëtar (përfshi atë të Kosovës) nuk ofron, një definicion të dallueshëm të “alternativave të arsyeshme”, por përcaktimet / zgjedhjet e “alternativave të arsyeshme” i është lënë vlerësimit dhe vendimit të sipas rasteve. Alternativa e zgjedhur duhet të jetë realiste. Pjesë e arsyeve për studimin e alternativave, është që të gjenden mënyra për reduktimin apo shmangien e efekteve të kundërta mjedisore të planit dhe programit të propozuar. Brenda procesit të parashikimit të ndikimeve potenciale të të dy ndikimeve, sasiore (zona e tokës bujqësore/vendbanimeve natyrore të humbura për qëllime të banimit) dhe cilësore (lëvizshmëria e rritur e qytetarëve) dhe ndikimi direkt dhe indirekt, primar, sekondar dhe me

lartë, afat- shkurtër-mesëm-gjatë: të përkohshëm dhe permanent (kalkulimet, masat etj) duhet të listohet. Në fazën e vlerësimit ato ndikime duhet të vihen në prioritet dhe të analizohet relevanca e tyre.

- rritja e mundësive, zbutja e ndikimeve negative. Është e rëndësishme të fokusohemi në realizimin e mundësive pozitive të aktiviteteve të planifikuara dhe në zvogëlimin e rreziqeve negative. Qëllimi është që të zhvillohen “fito-fito” situata ku fitimet e shumta dhe të përbashkëta mund të forcojnë bazën ekonomike, ofrojnë kushte të barabarta për të gjithë, dhe mbrojnë dhe përmirësojnë mjedisin. Aty ku është e pamundur shkëmbimet duhet të dokumentohen në mënyrë të qartë për të udhëzuar vendim-marrësit. Hierarkia e zbutjes duhet të ndiqet për efektet negative të identifikuar; së pari shmang; së dyti redukto; dhe së treti mënjano efektet negative- duke përdorur masat e duhura. Duhet të ushtrohet kujdes nëse analiza tregon një potencial për ndikime të mëdha, të pakthyeshme dhe negative në mjedis.

- raportimi. Raporti i VSM-së / Mjedisor është rezultati kyç i procesit të VSM-së i cili do të prezantoj informacion mbi efektet e draft planit ose programit. Në rast të raportimit, legjislacioni ( të dy, Direktiva dhe legjislacioni kombëtar i Kosovës) jep kërkesat themelore për raportin mjedisor. Detyra e raportit është për të identifikuar, përshkruar, dhe vlerësuar efektet e mundshme mjedisore të planit ose programit dhe alternativat e veta të arsyeshme, të ofroj informacion rreth procedurave të konsultimeve dhe të sugjeroj masat e mëtejme për të monitoruar zbatimin e planit. Dispozitat e mëtejme në të cilat duhet të ofrohen informacionet duke marrë parasysh këto efekte në Anekset e akteve ligjore të përmendura më lart.

### 3.2 PALËT KONSULTUESE

Në mënyrë që të ruaj të arriturat e qëllimeve të veta dhe ndjek parimet e përfshirjes efektive draft raporti i VSM-së duhet të paraqitet dhe të diskutohet me të gjitha institucionet relevante, siç janë:

- Administrata Komunale e Mamushës;
- Publiku në përgjithësi dhe grupet relevante të interesit të Mamushës;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës
- Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit
- UN-Habitat Kosovë

### 3.3 AFATI KOHOR

Sipas legjislacionit kombëtar të Kosovës VSM-ja duhet të kryhet gjatë përgatitjes së planit apo programit dhe para miratimit të tij. Procesi i përgatitjes së PZHK-së së Mamushës ka filluar në vitin 2010 gjatë fazës së dytë të Programit Mbështetës të Planifikimit Hapësinor dhe VSM-ja filloi në fillim të vitit 2012, që përbëhet nga rishikimi i literaturës (Aneksi 2), metodologjia (Aneksi 3), komentet preliminare të kapitujve të parë të PZHK-së dhe raporti i studimit. Raporti i studimit është paraqitur dhe diskutuar me palët përkatëse të interesit gjatë punëtorisë publike në qershor të vitit 2012. Përveç kësaj ishin mbajtur tre sesione trajnuese interaktive me palët e interesuara (stafi komunal, UN-Habitat) për të shkëmbyer dhe ndarë njohurit dhe përvojën rreth proceseve të VSM-së. Procesi i përbërjes së PZHK-së dhe VSM-së shkoi paralelisht. Kapitujt e PZHK-së u rishikuan dhe vlerësuan për nga ana mjedisore shumë shpejt pasi ajo u hartua dhe për këtë arsye drafti i parë i PZHK-së (i finalizuar në tetor të vitit 2012) tashmë kishte të përfshirë disa sugjerime nga ekspertët e VSM-së. Drafti i raportit të VSM-së ishte finalizuar menjëherë pas draftit të parë të PZHK-së.

## IV. PËRMBLEDHJE E ELEMENTEVE TË PZHK-së SË MAMUSHËS

Komuna e Mamushës si një njësi e pavarur administrative është themeluar kohëve të fundit (është bërë komunë pilote në vitin 2005, statusi i plotë u fitua në vitin 2008) dhe si rezultat nuk ka shumë dokumente planifikimi për komunën. Në vitin 2009 ishte hartuar Strategjia Zhvillimore Lokale për komunën e Mamushës, mirëpo nuk përfshinte asnjë komponent hapësinore. Për këtë arsye PZHK-ja aktuale wshw vlerësuar qw është dokumenti i parë i planifikimit hapësinor. Hartimi i dokumentit kwrkohet me ligj dhe PZHK-ja e Mamushës është përgatitur nga stafi Komunal i Mamushës nw bashkwpunim me UN-Habitat-in nw Kosovë.


PZHK-ja e Mamushës është e strukturuar në 5 kapituj, kapitulli i parë - profili komunal në tërësi përshkruan situatën aktuale në vend, duke mbuluar një varietet të mirë të fushave dhe sektorëve të ndryshw – ekonomi, burime natyrore, arsim, kulturë etj, kapitulli i dytë ka karakter strategjik dhe përfshin një vizion, parimet e zhvillimit dhe synimet. Bazuar në të dy kapitujt e parë, korniza zhvillimore hapësinore - ofron reflektimet hapësinore dhe analizat relevante të alternativave të mundshme zhvillimore për Mamushën. Kapitulli i katërt ofron strategjitë dhe veprimet e nevojshme zbatuese në mënyrë që parimet e PZHK-së të mund të zbatohen në dokumentet e tjera të planifikimit, procedurat administrative dhe zhvillim lokal. Në fund kapitulli i pestë ofron dispozitat per zbatim tw planit.

Qëllimi i PZHK-së së Mamushës është që të identifikoj qëllimet afatgjata për zhvillim ekonomik, social dhe hapësinor për tërë territorin e komunës. PZHK-ja mbulon fusha të politikave të shumëfishta të tilla si; banimi, rrugët dhe transporti, infrastruktura, hapësirat dhe ndërtesat publike, trashëgimia kulturore, bujqësia dhe pylltaria, zhvillimi rural dhe bashkëpunimi ndër - komunal. PZHK-ja përmban vizionin e të ardhmes për zhvillim që përcakton projektet për qëllime publike më me prioritet.

Kapitulli strategjik përcakton një deklaratë të vizionit për komunën e Mamushës si në vijim: Komuna e Mamushës e zhvilluar bazuar në burimet bujqësore dhe me mundësin për të krijuar burime alternative, me shërbime publike cilësore, infrastrukturë adekuate dhe një mjedis jetësor të pastër dhe të sigurt. Vizioni së bashku me parimet e përgjithshme të zhvillimit janë të drejtuara në përmirësimin e mjedisit natyror dhe jetësor, promovimin e qeverisjes së mirë dhe bashkëpunimit, ekonomisë stabile dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Qëllimet afatgjata zhvillimore janë të ndara në 5 fusha tematike: situata socio-ekonomike dhe demografia (1), zhvillimi ekonomik (2), infrastruktura dhe shërbimet publike (3), mjedisi, peizazhi, burimet natyrore/kulturore (4) dhe kapacitetet njerëzore dhe institucionale në fushën e planifikimit hapësinor (5). Brenda secilës fushë tematike janë paraqitur qëllimet dhe objektivat.

Korniza propozon dy skenarë të zhvillimit hapësinorë – Skenarin Linear dhe Skenarin e Koncentruar, që i përshkruan ato dhe i identifikon përparësitë dhe disavantazhet relevante për të dy skenarët. Gjithashtu është punuar një skenar i integruar ku komponentët e të dy skenarëve atij linear dhe të koncentruar janë të kombinuara, ky skenar është sugjeruar të jetë një strukturë e duhur për zhvillimet në të ardhmen në Mamushë. Karakteristika e përbashkëta tw të gjitha skenarëve të propozuar është përputhja me vizionin strategjik dhe qëllimet e PZHK-së ku toka bujqësore është mbrojtur nga banimet dhe industria dhe e rezervuar vetëm për përdorim bujqësor.

Harta IV.1 Skenari i preferuar për zhvillimin e komunës në të ardhmen



Burimi: Plani Zhvillimor Komunal i Mamushës 2014 – 2023 , 2012

Fazat e fundit të PZHK-së janë të reflektuara tek kapitulli i katërt dhe pestë, të cilat përfshijnë strategjitw dhe veprimet për zbatim dhe dispozitat pwr zbatim. Të gjitha këto dalin nga kapitulli strategjik dhe ndjekin strukturën e pesë fushave strategjike të lartë përmendura. Për secilën fushë janë propozuar një grup i projekteve/ programeve për zbatim sipas strategjisë dhe qëllimeve të fushave. Në mënyrë që të lehtësohet zbatimi ky kapitull ofron karakteristika të tilla si prioritetin, afatin kohor, financimin, institucionet përgjegjëse dhe treguesit e monitorimit për secilin nga projektet. Së fundi një gamë e gjerë e dispozitave për zbatim janë ofruar në kapitullin e fundit të PZHK-së.

Ekzistojnë udhërrëfyes për interpretimin e çështjeve të planit zhvillimor komunal gjatë hartimit të planeve rregulluese dhe planeve të tjera, kushtet e caktuara nga qeveria lokale në çështjet qw kanw tw bwjnw me zhvillimin dhe përdorimin e tokës së komunës dhe masat lehtësuese për të parandaluar degradimin mjedisor dhe social të renditura dhe të analizuar në mënyrë që të ofrojnë mbështetje të bazuar në dije për vendim-marrje në të ardhmen gjatë zbatimit të PZHK-së.

Komuna do të përdor PZHK-në për të negociuar me palët e ndryshme të interesit si ministritë dhe investitorët privat për zbatimin strategjik të projekteve komunale. PZHK-ja paraqet zonimin e përdorimit të tokës në të ardhmen brenda territorit të komunës për zhvillimin, ruajtjen e tokës, apo restriksionet veçanërisht në zonat rurale. PZHK-ja gjithashtu ofron udhëzimet themelore për infrastrukturë, madhësinë, lartësinë dhe dukjen e zhvillimeve të reja. Të gjitha aplikacionet për pëlqim (aplikacionet e planifikimit) duhet të referohen tek politikat e PZHK-së dhe të jenë në përputhje me natyrën e planit. Në praktik, ka burime të vlefshme natyrore si lumenj, pyje, terrene kodrinore dhe male të cilat duhet të ruhen në mënyrë adekuate nëpërmjet restriksioneve të zonave të ndërtimit. Toka pjellore dhe pyjet janë gjithashtu burime kyçe për komunën, duhet të ruhet për përfitime të ekonomisë rurale lokale si dhe për vlera të peizazhit.

Një nga pikat e forta dhe vlerat e PZHK-së së vlerësuar është natyra e saj zbatuese, që ofron bazat analitike dhe të justifikuara për zhvillimin e mëtejshëm të Mamushës deri në vitin 2020 për të gjitha palët relevante të interesuara - administratën lokale, komunitetin, sipërmarrësit dhe investitorët potencial dhe partnerët. Përfshin kornizën hapësinore si një input efektiv për dokumentet për planifikim të nivelit më të ulët dhe ruajtjen e vlerave natyrore dhe bujqësore, dhe sugjerimeve zbatuese për planifikim, programim dhe buxhetim të mëtejshëm.

## **V. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR, PLANET E TJERA, PROGRAMET, KONVENTAT DHE PROTOKOLLET**

Pasi që komuna e Mamushës është bërë autoritet i pavarur lokal në vitin 2005 së pari duke u bërë pilot komunë në vitin 2008 si tërësisht e pavarur (para vitit 1999, Mamusha si fshat i ka takuar komunës së Prizrenit) ka pasur vetë disa strategji zhvillimore lokale dhe dokumente tjera relevante. E vetmja strategji hapësinore para PZHK-së aktuale janë dokumentet planifikuese të krijuara nga komuna e Prizrenit ku përfshihej Mamusha si një fshat. Dokumenti i vetëm i hartuar për komunën e Mamushës është Strategjia Zhvillimore Lokale në vitin 2009, e cila nuk përfshin asnjë komponent hapësinore. Për këtë arsye ky kapitull përfshin vetëm pasqyrën dhe analizat e dokumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

### **5.1 DIREKTIVA e BE-së PËR VSM-së**

Baza ligjore e VSM-së në Unionin European është Direktiva e Këshillit 2001/42/EC për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis (Direktivat e VSM-së), është miratuar në vitin 2001. Parimet e direktivës janë integruar në legjislacionin e shteteve anëtare dhe përveç kësaj edhe shtetet candidate dhe shtetet me mundësi të kandidimit kanë huazuar parimet e kësaj direktive në legjislacionin e tyre. Që nga viti 2010 parimet e përmendura më poshtë janë integruar edhe në legjislacionin e Kosovës. Direktiva e VSM-së aplikohet për një gamë të gjerë të planeve dhe programeve publike (p.sh. përdorim të tokës, transport, energji, mbeturina, agrikulturë, etj). VSM direktiva nuk i referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian..., 2001) thotë se „planet dhe programet në kuptim të Direktivës së VSM-së duhet patjetër të përgatiten apo adoptohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, regional, lokal) dhe duhet të kërkohen me dispozitat legjislative, rregullative apo administrative”.

VSM-ja është obligative për planet/programet të cilat janë të listuara në Direktivë si në vijim:

- „ janë të përgatitura për agrikulturë, pylltari, peshkatari, energji, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ujit, telekomunikacion, turizëm, planifikim të qytetit/vendit apo përdorim të tokës e cila e përcakton kornizën për zhvillim në të ardhmen të projekteve të listuara në Direktivën e VNM-së;
- është vendosur që të kërkoj një vlerësim nën Direktivën e Habitatit“.

Në përgjithësi, për planet/programet jo të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet të kryejnë një procedurë ekzaminimi për të përcaktuar nëse planet/programet kanë të ngjarë të kenë një efekt të rëndësishëm mjedisor. Nëse ekzistojnë efekte të rëndësishme, nevojitet një VSM-ë. Procedura e ekzaminimit është e bazuar në kriteret e caktuara në Aneksin II të Direktivës.

Procedura e VSM-së mund të përmblihet si në vijim: raporti i VSM-së është i përgatitur, në të cilin efektet e mundshme të rëndësishme dhe alternativat e arsyeshme të planit apo programit të propozuar janë të identifikuar. Autoritetet publike dhe mjedisore janë të informuara dhe të këshilluara mbi draft planin apo programin dhe është përgatitur raporti i VSM-së. Raporti i VSM-së dhe rezultatet e konsultimeve janë marrë parasysh para miratimit. Pasi që plani apo programi të jetë miratuar, autoritete mjedisore dhe publiku të jenë informuar dhe informacioni relevant të jetë në dispozicion për ata. Në mënyrë që të identifikohen efektet negative të paparashikuara në faza më të hershme, efektet e rëndësishme mjedisore të planit apo programit duhet të monitorohen.

## 5.2 DIREKTIVAT TJERA TË BE-së

Ka shumë Direktiva tjera të BE-së që Direktiva e VSM-së ka një marrëdhënie të qartë dhe të cilat janë relevante nëse çështjet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë janë marrë parasysh (shih listën në Aneksin 4). Sipas Marsden-it (2008) „ VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën e VNM-së, posaçërisht pasi VM-ja për sektorët e listuar më vonë duhet të përcaktoj kornizën ligjore për projektet e listuar nën ato më të hershme. Gjithashtu ka lidhje të ngushtë me Direktivën e Habitat-it që në mënyrë eksplicite përmendet në Direktivën e VSM-së. Direktiva e Kornizës Ujore, së bashku me Direktivën e Habitat-it përmban kërkesat jo vetëm për hartimin e planeve ( programeve) por edhe vlerësimin, duke nxitur nevojën për procedura të koordinimit mes ligjeve të ndryshme”. Një nga më relevantet në kontekst të PZHK-së së Mamushës është Direktiva e Kornizës Ujore (ka hyr në fuqi në Dhjetor të vitit 2000) si direktiva që adreson një nga çështjet intriguese mjedisore në Mamushë – kualiteti i trupave ujqor. Synimi i përgjithshëm i direktivës është që të përmirësoj gjendjen cilësore dhe sasiore (statusin ekologjik dhe kimik) të të gjithë trupave ujqor. Një nga qasjet për të arritur këtë synim është hartimi i planeve për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore. Ngjashëm me këtë direktivë PZHK-ja aktuale e vlerësuar përfshin një qëllim për të promovuar menaxhimin dhe trajtimin e ujërave të zeza nëpërmjet aktiviteteve adekuate. Aktiviteti relevant për të arritur atë qëllim është ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujit. Edhe pse kjo duket e pamundur arritja e qëllimeve të direktivës në Kosovë apo Mamushë deri në vitin 2015, qasja e ndërmarr në Mamushë është në pajtueshmëri me parimet e direktivës. Pasi lumenjtë janë trupat ujqor sipërfaqësor më të rëndësishëm në Kosovë qasja e pellgjeve regjionale të lumenjve mund të jetë e dobishme për të përballur sfidat e ndotjes në Kosovë/Mamushë (ka nevojë për bashkëpunim ndër-komunal). Dokumenti tjetër ligjor i Bashkimit Evropian për të adresuar edhe një çështje vitale mjedisore – mbeturinat e ngurta – është Direktiva e Kornizës Ligjore për Mbeturinave (e vlefshme që nga viti 2008). Një nga konceptet kyçe të kësaj direktive është parandalimi i prodhimit të mbeturinave – thekson nevojën për reduktuar sasinë e mbeturinave të depozituara nëpër deponi nëpërmjet ripërdorimit dhe riciklimit. Për shkak të gjendjes jo të mirë të grumbullimit të mbeturinave dhe sistemit për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë (një sasi e madhe e mbeturinave të ngurta është deponuar nëpër natyrë në mënyrë të pa ligjshme dhe jo në mënyrë të duhur) prioriteti i parë i PZHK-së është caktimi i një sistemi funksional për grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe deponimit në mënyrë të duhur. Edhe pse parashihet disa masa për të promovuar dhe zbatuar fushat e tjera prioritare të direktivës ( ngritjen e vetëdijes, plane menaxhimi dhe stacione transite të mbeturinave) zbatimi efektiv i sistemeve të riciklimit dhe ripërdorimit ka nevojë për mekanizma koordinues kombëtar nga niveli kombëtar i qeverisjes.

### 5.3 STRATEGJIA 2020 E BE-së

Përveç dokumenteve të lartpërmendura legjislativë të BE-së, Strategjia 2020 e BE-së me prioritetet e saj, objektivat dhe iniciativat udhëheqëse<sup>1</sup> është dokument i rëndësishëm i politikave si për vet BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, posaçërisht për Ballkanin Perëndimor pasi që bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si një nga prioritetet e politikës për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe i vendeve të punës. Prioritetet e strategjisë janë „rritja e zgjuar, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse“. Ekzistojnë shtatë iniciativa udhëheqëse, prej të cilave *Europa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* do të mundeshin po ashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji po ashtu përfshihen objektivat e matshme që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serra, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjërat e përtëritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit kombëtare, rajonale dhe lokale për mjedis, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

Ekziston lidhja në mes të Strategjisë së BE-së 2020 dhe PZHK-së së vlerësuar aktuale, por ato janë disi indirekte. Qasja dhe aktivitetet e PZHK-së kontribuojnë efektivisht në shumicën e objektivave të strategjisë të tilla si reduktimi i varfërisë, përjashtimi social, shkalla e papunësisë dhe e braktisjes së shkollës. Megjithatë duhet të theksohet se aktualisht çështjet e efikasitetit të energjisë nuk janë veçanërisht të mbuluara mirë me PZHK-në.

### 5.4 OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË MIJËVJEÇARIT TË KB-së

KB-ja ka një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB-ja vepron në Kosovë sipas mandatit të misionit të UNMIK-ut, në mënyrë që të siguroj kushte për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe të avancojë stabilitetin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB-së janë miratuar në vitin 2000, kur liderët botërorë u mbledhën në Nju Jork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB-së (Asambleja e Përgjithshme e KB-së, 2000) me një qëllim kryesor të përgjithshëm për të ulur varfërinë me afatin deri në 2015. Kjo iniciativë u bë e njohur si Objektivat e Zhvillimore të Mijëvjeçarit<sup>2</sup>. Ekzistojnë 7 qëllime me objektiva të veçanta, njëri nga qëllimet është i dedikuar për qëndrueshmërinë e mjedisit, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- “integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthimi i humbjes së burimeve mjedisore;
- zvogëlimi i humbjes së biodiversitetit, duke e arritur, deri në vitin 2010, reduktimi i konsiderueshëm në normën e humbjes;
- Përgjysmimi, deri në vitin 2015, i proporcionit të popullsisë që nuk kanë qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm dhe kanalizime themelore;
- deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetët e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra “.

Në rastin e Mamushës më të rëndësishme janë objektivat rreth humbjes së biodiversitetit dhe qasjes në ujë të pijshëm dhe kanalizime (duke përfshirë ujërat e zeza). PZHK-ja përfshin masa të tilla si mbrojtja e pyjeve dhe zonave tampon përgjatë lumenjve për ruajtjen e biodiversitetit, si dhe aktivitetet për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe sistemit të

<sup>1</sup> Informacione të mëtejshme në lidhje me strategjinë dhe progresin e zbatimit të saj mund të gjenden: [http://ec.europa.eu/europe2020/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm)

<sup>2</sup> Informacione të mëtejshme në lidhje me qëllimet dhe përparimin e zbatimit mund të gjenden: <http://ëëë.un.org/millenniumgoals/bkgd.shtml>

kanalizimit. Përveç qëllimeve lidhur me çështjet e mjedisit, synimet për të adresuar varfërinë dhe barazinë gjinore janë të rëndësishme në Mamushë.

## 5.5 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE VSM NË KOSOVË

### 5.5.1 INFORMATA LIDHUR ME HISTORIKUN E KOSOVËS

Analiza strategjike mjedisore e REC–ut (Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore) për Kosovën (REC, 2008; 5, 8,18) përshkruan Kosovën me "një sipërfaqe prej 10.887 kilometra katrorë. Që mbulon një sipërfaqe prej 1.100.000 ha. Rreth 430.000 ha janë pyllëzuar (39.1%) dhe 577.000 ha janë klasifikuar si tokë bujqësore (52%). Prej këtyre të fundit, 31% janë kullota dhe rreth 69% është e punueshme. Është një pellg gjeografik, ndodhet në lartësi mbidetare prej rreth 500 metra, e rrethuar nga malet, dhe e ndarë nga vargmali qendror veri / jug në dy nën-rajone me madhësi dhe popullsinë përafërsisht të barabartë. Ajo është pjesë e rajonit të Evropës Juglindore (apo e Ballkanit) dhe kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje, Malin e Zi në Perëndim, Shqipërinë në Jug Perëndim, dhe me IRJ të Maqedonisë në Jug Lindje . Ka një klimë kontinentale, e njohur nga temperaturat ekstreme dhe në dimër ndodhin shpesh inverzionet (përmbysjet) termike. Përqendrimi i llojeve endemike lokale ndodhet në kufirin jugperëndim të Kosovës, në verilindje të Shqipërisë dhe në veriperëndim të IRJ të Maqedonisë, përkatësisht në Malin e Sharrit. Kjo zonë malore është e lidhur me Prokletije, Durmitor dhe malet bregdetare Dinara dhe përfaqëson qendrën e Ballkanit të biodiversitetit endemik. Territori i Kosovës ka një park kombëtar (Malin e Sharrit Mt.), Dy parqe rajonale, 11 rezervate natyrore, 32 monumente të natyrës, etj. Megjithatë vetëm një gjysmë për qind e territorit të saj është nën mbrojtje. Brenda kësaj hapësire të vogël ekziston një larmi e madhe e të dyja specieve dhe habitateve . Ekzistojnë më shumë se 2000 lloje të florës vaskulare në Malin e Sharrit. Kjo është rreth 26% e e Ballkanit dhe 18% e florës Evropiane. Kjo pasuri e specieve është një shembull i pasurisë të jashtëzakonshme floristike. Analiza e zonës-spektrit tregon se më të shumta janë endemike (rreth 29%) dhe taksonet nën-endemike (rreth 10%), që përbëjnë rreth pothuajse 40% të florës endemike të Malit të Sharrit. Këto shifra e vendosin Malin e Sharrit në qendër të gjenit dhe diversitetit të specieve evropiane dhe globale. Kosova është relativisht e pasur në burime natyrore. Ajo ka një nga rezervat më të mëdha të thëngjillit të përdorshëm (linjtit) në Evropë, plus minerale të tjera. Gjithashtu ajo posedon një biodiversitet shumë të pasur, të përqendruar në zonën përreth malit Sharr në Jug Perëndim të Kosovës “.

Edhe pse parimi rritjes së qëndrueshme është i integruar në Strategjinë Kosovare të Zhvillimit dhe Planin (SKZHP) aktiviteti më i rëndësishëm zhvillimor në lidhje me çështjet mjedisore mund të vlerësohet se është Strategjia Kosovare e Mjedisit (SKM). Ajo u miratua në vitin 2004 nga Qeveria e Kosovës. Analiza mbi Mjedisin dhe Klimën e Kosovës e përgatitur nga Shkolla e Ekonomisë, Biznesit dhe Ligjit, të Universitetit të Goteborgut, Njësia e Departamentit të Ekonomisë dhe Mjedisit Ekonomik (2008) përcakton strategjitë e qëllimeve afatgjata si më poshtë:“ Përmirësimi i cilësisë së jetës për njerëzit, shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe shmangia e efektit të dëmshëm në mjedis. SKM ka shtatë fusha strategjike: 1) ajrin (duke përfshirë ndryshimin e klimës dhe acidifikimin), 2) ujin; 3) tokën; 4) trashëgiminë natyrore; 5) biodiversitetin; 6) mbeturinat; dhe 7) menaxhimin e rrezikut dhe fatkeqësive “.Lidhur me ndryshimin e klimës disa nga prioritetet janë krijimi i një organi koordinues, monitorimi i emetimeve të gazrave serrë, dhe duke qenë aktive në diskutimet ndërkombëtare për ndryshimin e klimës. Ndryshimi i klimës është përmendur në këtë mënyrë në sa i përket zbutjes në vend të përshtatjes. E njëjta gjë vlen për Planin e Veprimit të Kosovës për Mjedisin (PVKM), i cili ishte nisur nga MMPH në maj të vitit 2006 dhe të miratuar në janar 2007. Theksohet se PVKM duhet të ndihmojë në forcimin e procesit të ardhshëm të aderimit të Kosovës në BE

### 5.5.2 HISTORIKU LEGJISLATIV KOMBËTAR

#### Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji i ri për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji nr. 03/L-106) duke pasur si qëllim kryesor sipas Nushi (2011) "është për të rregulluar të gjitha çështjet që lidhen me planifikimin hapësinor dhe urban". Gjatë përgatitjes së VSM-së aktuale drafti i ri i Ligjit mbi PH-në ishte duke u përgatitur dhe konsultuar me palët e interesit, me një perspektivë që të hyjë në fuqi në fund të vitit 2012. Sipas këtij akti ligjor planifikimi hapësinor duhet "ti ndjek parimet e mbrojtjes së



burimeve natyrore të Kosovës dhe avokimi i zhvillimit të qëndrueshëm, gjithashtu duhet të promovojë proceset përfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet të përfshijë të gjithë aktorët dhe komunitete". Promovimi i harmonizimit me zhvillimet e vazhdueshme hapësinore Evropiane është gjithashtu njëri ndër parimet.

Është parashikuar se ekspertiza profesionale është e integruar në sistemin e planifikimit duke krijuar Komitetet e Ekspertëve të Planifikimit (në nivel lokal) dhe Këshillit për Planifikim Hapësinor (në nivel kombëtar). Ka 2 nivele të planifikimit në Kosovë (kombëtar dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet Zhvillimore Urbane (PZHU), Planet Rregulluese Urbane (PRrU) . Për të gjitha këto lloje të planeve shqyrtimi dhe mundësitë për pjesëmarrjen publike janë të detyrueshme. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën e tanishme është plani multi-sektorial për tërë territorin e komunës që përcakton qëllimet afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet të mbulojë periudhën prej së paku 5 vitesh dhe të përfshijë një plan për zhvillimin e zonave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Ai duhet të përfshijë një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve socio-ekonomike dhe mjedisore.

Nushi (2011) identifikon institucionin kryesor që është përgjegjës për zbatimin e ligjit të lartpërmendur në nivel kombëtar të jetë MMPH-ja e cila "në përputhje me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinorë është përgjegjëse për koordinimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe propozimin e politikave të zhvillimit hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor. MMPH është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e dokumenteve përkatëse dhe raporteve mbi planifikimin hapësinor, të rishikojë dhe monitorojë të gjitha dokumentet e planifikimit në të gjithë territorin " .

Në kuadër të sistemit të Kosovës të planifikimit në dy nivele, niveli i qeverisjes lokale ka rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve dhe të kërkesave planifikuese të përcaktuara nga Ligji për Planifikimin Hapësinor. Sipas Tofaj dhe të tjerët (2010; 1137) 'komunat e Kosovës luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e komuniteteve të tyre, duke krijuar pasuri dhe duke imponuar identitetin lokal. Shoqëria duhet të ketë udhëheqje të fuqishme që i bashkon të gjitha palët e interesuar relevante, përfaqësuesit e komunitetit dhe të biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e strategjisë duke u bazuar në një vizion të përgjithshëm. Ky është njëri nga aktivitetet kryesore që pritet ta kryejnë komunat. Është interesante të vihet re që sipas rrethanave aktuale roli i agjencive ndërkombëtare (siç është UN-Habitat) është më i madh se që pritet për shkak të grandeve të donatorëve, deri në atë pikë sa që konsiderohet palë me interes në proces. Megjithatë, me kalimin e kohës dhe deri sa komunat të tregojnë nivele të rritura të kapacitetit profesional dhe financiar, roli i agjencive ndërkombëtare do të duhet të zvogëlohet vetëm për t'i stimuluar proceset dhe projektet. Përvoja në planifikim në të kaluarën para konfliktit (ku pjesa më e madhe e pasurisë ka qenë pronë shtetërore) ishte që pushteti lokal i lehtësonte dhe i realizonte të gjitha këto aktivitete vetë. Ndërsa, planifikimi bashkëkohor strategjik promovon qasjen sipas së cilës pritet që qeveria lokale ta kryejë pjesën më të madhe të aktiviteteve të saj në partneritet me sektorin privat dhe me agjencitë ndërkombëtare, ndërsa i përfshin zërat e komunitetit në mënyrë konsekuente".

## **Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor**

Ky ligj thekson rëndësinë e integritit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në përgatitjen, miratimin dhe realizimin e planeve

- emetimet në ajër nga automjetet për grumbullimin e mbeturinave dhe bartjen e tyre
- trajtimi i veçantë dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme

Kur bëhet fjalë për hedhjen e paligjshme të mbeturinave dhe sistemin jo-adekuat për menaxhimin e mbeturinave është e rëndësishme që të theksohet që ky problem nuk mund të zgjidhet vetëm në nivel të qeverisjes vendore. Vendndodhja e deponive dhe sistemi i menaxhimit duhet që të koordinohen nga autoritetet kombëtare. Megjithatë, zgjidhjet lokale (të tilla si stacionet e transitit të mbeturinave) janë dëshmuar të jenë efektive dhe ia vlen që të zbatohen edhe në Mamushë gjithashtu. Sipas UN-Habitat (2012) „madhësia dhe vendndodhja e deponive përcakton koston dhe faktorët e jashtëm. Përparesia e koston së ndërtimit dhe operimit në shkallë të gjerë nga deponitë e mëdha mbi deponitë e vogla ka rezultuar në një trend të deponive rajonale. Deponitë e mëdha mund të jenë më efektive në koston për ton por mund të kenë kosto më të mëdha të transportit dhe efekte negative mbi vlefshmërinë e pronës se sa deponitë e vogla; ato gjithashtu janë të papëlqyera nga komuniteti. Vendndodhja e deponisë mund të minimizojë faktorë të tillë si rritja e trafikut, zhurma, erëra të pakëndshme, degradimi i mjedisit dhe përdorimin e kufizuar të tokës, dhe tampon zonat përcaktojnë se ku nuk duhet që të vendosen këto deponi.

Masa të tilla si sigurimi i hapësirave për klasifikim dhe riciklim afër zonave ku janë gjeneruar mbeturinat mund të ndihmojë zvogëlimin e shkatërrimit të vendeve nga mbeturinat“. Gjatë themelimit të një sistemi të fortë për trajtimin e mbeturinave duhet që të konstatohet që deponia/stacioni transit për trajtimin e mbeturinave nuk është një strukturë e lehtë për tu vendosur dhe mund që të mos mirëpritet nga komuniteti lokal për shkak të frikës nga erërat, insektet, brejtësit, emisionet e gazrave dhe ndotja e ujit që mund të rezultojë. Në rastin e Mamushës mbeturinat e ngurta duhet që të vendosen në një deponi jashtë kufijve të komunës mirëpo shqetësimi kryesor do të jetë mbledhja e mbeturinave të ngurta nga familjet – përveç efekteve mjedisore të mësipërme duhet që të merret parasysh edhe aspekti social pasi që ka ende nevojë për përmirësim të mëtutjeshme të zakoneve të banorëve që të përfshihen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe paguajnë për të.

Grumbullimi i mbeturinave të ngurta është një nga problemet më të mëdha në komunën e Mamushës. Ekzistojnë dy deponi joformale të cilat nuk menaxhohen në qytet dhe shkaktojnë degradimin e mjedisit. Asgjësimi i pahijshëm ndot ujin në tokë dhe djegia e mbeturinave mund të rezultojë në kimikate toksike të cilat lëshohen në atmosferë. Vendosja e deponive në terren të shtrirë të ulët natyror, paraqet potencial për rritjen e ndotjes dhe mbeturinave gjatë rasteve të përmblyetjeve, drejt vendbanimeve, duke paraqitur rrezik për shëndetin në të njëjtën kohë.

Grumbullimi formal i mbeturinave të ngurta në Mamushë menaxhohet nga kompania private I&S. Sipas kësaj kompanie 150 familje janë duke paguar tarifën për shërbime kurse të tjerat kanë zgjedhur që të hedhin mbeturinat e



tyre në mënyrë joligjore të mos paguajnë për shërbimin në fjalë. Performanca e tyre varet në normën e pagesës për mbledhje nga qytetarët për këtë shërbim. Pas raporteve të kompanisë, niveli i taksave të mbledhura është vlerësuar të jetë 23%. Sasia e mbeturinave për prodhuara për kokë është 300 kg/për vit. Nuk ka asnjë klasifikim dhe riciklim të mbeturinave të ngurta në Mamushë. Pika grumbulluese për Komunën e Mamushës është në Landovicë, e cila merr rreth 15 ton/në muaj.

Faktori kryesor që shkakton degradim janë mbeturinat e ngurta. Zakonisht degradimi shkaktohet nga mbeturinat e ngurta që hidhen në tokë boshe dhe në lumenj. 23 % e popullsisë së Mamushës i mbledhin dhe hedhin mbeturinat në kompanisë e cila është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave, kurse 77% e popullsisë i hedhin mbeturinat në lumenj, etj. Për të adresuar çështjet e identifikuara mjedisore gjatë implementimit të raportit të PZHK-së, raporti aktual i VSM-së propozon një sërë objektivash mjedisore të cilat duhet të përmbushen gjatë periudhës së PZHK-së.

## VII. OBJEKTIVAT MJEDISORE, TREGUESIT DHE SYNIMET

VSM-ja përdor një kombinim të objektivave, tregueseve dhe synimeve për të parashikuar efektet, përshkruar dhe monitoruar ndryshimin e planeve dhe programeve të propozuara në fushën e mjedisit. Objektivat Strategjike Mjedisore dhe synimet përcaktojnë qëllimet dhe pragjet të cilat duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të ndikimit të Planeve dhe Programeve mbi mjedisin. Aleatë për zhvillimin e NP-ve janë treguesit dhe caqet mjedisore. Indikatorët ndihmojnë në aspektin e monitorimit të VSM-së, ndërsa synimet ofrojnë synime reale dhe të arritshme për të cilat autoritetet lokale mund të punojnë. Treguesit përdoren për të ilustruar dhe komunikuar efektin në një mënyrë të thjeshtë dhe efektive. Treguesit mund të përdoren gjithashtu për të formuar bazën për monitorimin e programit të PZHK-së.

**Objektivat mjedisore** sigurojnë një “qëllimi” pikë referues kundër të cilit efektet mjedisore të planit mund të testohen. Ato duhet që të jenë zakonisht të ngjashme me masat që janë në PZHK ose që dalin nga objektivat që mund të ekzistojnë. Shembuj të objektivave mjedisore: ulja e zhurmës dhe dridhjes në zonat e banuara, rritja e kualitetit të ujit në ujërat sipërfaqësor, ulja e emetimeve të CO<sup>2</sup> nga transporti apo gjenerimi i energjisë elektrike, minimizimi i ndikimeve ose vendbanimeve të caktuara.

**Treguesit** ofrojnë mjetet për të matur progresin drejt arritjes së objektivave mjedisore me kalimin e kohës të tilla si ankesat e zhurmës të marra gjatë një periudhe specifike kohore, kualitetit të lumit/liqenit, tonelatave të emetuara të CO<sup>2</sup>-së për vit, zonat e përcaktuara të vendbanimeve.

**Qëllimet** përshkruajnë gjendjen e dëshirueshme në lidhje me çdo objektiv në terma sasiorë, siç vijon: ulje prej 50% e ankesave të zhurmës, përmbushja e objektivave të kërkuara nga rregulloret e fosforit, X tonelata të CO<sup>2</sup> të emetuara deri në vitin 2020 ose ndikime jo të rëndësishme për popullatën e llojeve të mbrojtura. Është e rëndësishme që treguesit të jenë të matshëm dhe objektivat të jenë reale dhe të sigurojnë që ekzistojnë rrjete monitoruese për matjen e treguesit, ose që ka burime në dispozicion për ndërtimin e rrjeteve të reja monitoruese. Qëllimet sasiorë dhe treguesit janë më të dobishëm se sa ata cilësor, pasi që ata mund të gjenerojnë të dhëna të prekshme dhe reale për aq kohë sa janë realiste, janë më lehtë që të monitorohen. Megjithatë, treguesit cilësorë nuk duhet që të nën-vlerësohen, sepse nganjëherë ato janë i vetmi opsion në dispozicion për matjen e performancës.

Objektivat, qëllimet dhe treguesit tashmë janë propozuar në fazën e studimit dhe diskutuar gjatë punëtorive publike. Për shkak të faktit se ka mungesë të sistemeve të monitorimit të mjedisit në Mamushë / Kosovë në këtë moment shumë tregues dhe qëllime janë në shkallën e përmirësimit në një gjendje të veçantë të mjedisit.

Fusha	Objektivi	Synimi	Treguesi
Uji	Rritja e kualitetit të ujit të pijshëm	30%	Përmirësimi (%) i cilësisë së ujit të sistemit qendror të ujit
	Diversifikimi i burimeve të ujit të pijshëm	2	Burime të reja të ujit të pijshëm
	Sigurimi i qasjes në sistemin e kanalizimit, trajtimi i ujërave të zeza	50%	Përqindja e ujërave të zeza që trajtohen siç duhet; Kualiteti i ujërave të zeza të trajtuara;
Përdorimi i Tokës	Ruajtja e tokës së punueshme	90%	Hektarë/përqindja e tokës së punueshme që ruhet nga vendbanimet/industria etj
	Shmangia e zonave jo-formale të banimit	80%	Ulja (%) e shumës së hektarëve/metrave katrorë të zonave me banim jo-formale
	Përmirësimi i cilësisë së zonave të banimit dhe sigurimi i hapësirave të hapura cilësore dhe shërbimeve shoqërore	Treguesi cilësor	Përmirësimi i cilësisë së jetesës
Bujqësia	Ri-aktivizimi i vreshtave	70%	Hektarët/përqindja e vreshtave të ri-aktivizuara
	Ulja e ndotjes në tokë dhe në ujë nga plehurat	50%	Shtirirja e tokës së pa-ndotur
Mbeturinat	Eliminimi i deponive ilegale	80%	Eliminimi i përqindjes së hedhjeve ilegale ose kthimi i tyre në stacione transite të mbeturinave
	Vendosja e një sistemi për grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe trajtim	50%	Rritja e (%) nr. të ekonomive familjare të përfshira në mbledhjen e duhur të mbeturinave të ngurta dhe të sistemit të trajtimit
Peizazhi	Ofrimi i kushteve për ruajtjen e biodiversitetit	Treguesi cilësor	Rritja e numrit të vendbanimeve, ruajtja e vendbanimeve të tanishme
	Integrimi i rrjeteve ekologjike në komunë	10%	Shtirirja/përqindja e elementeve të rrjetit ekologjik (korridoreve të gjelbra, zonave kryesore të mbrojtura, zonave të shmangura)
Energjia	Sigurimi i energjisë alternative (diellore, me erë)	20%	Përqindja e përdorimit të energjisë totale
Transporti	Vendosja e kushteve për transport të qëndrueshëm, trotuar të sigurtë/rrugë për çiklizëm	2km	Gjatësia e trotuareve të reja apo të rinovuar/rrugëve për çiklizëm

## VIII. VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE TE PZHK-së

Kapitulli strategjik përcakton një deklaratë rreth vizionit për komunën e Mamushës siç vijon:

Komuna e Mamushës – zhvilluar në bazë të burimeve bujqësore dhe me aftësinë për të krijuar burime alternative, me shërbime cilësore publike, infrastrukturë të përshtatshme dhe mjedis të sigurve dhe të pastër.

Vizioni së bashku me parimet e përgjithshme të zhvillimit janë të drejtuara drejt përmirësimit të mjedisit natyror dhe jetësor, duke promovuar qeverisjen e mirë dhe bashkëpunimin, ekonomi dhe zhvillim të qëndrueshëm dhe prandaj nuk ka ndikime të rëndësishme negative që nuk mund të identifikohen nëse këto parime do të zbatohen me aktivitetet e parapara në PZHK. Qëllimet afatgjata të zhvillimit janë ndarë në 6 fusha tematike: demografia dhe situata socio-ekonomike (1), zhvillimi ekonomik (2), infrastruktura dhe shërbimet publike (3), përdorimi i tokës, banimi dhe vendbanimi (4), mjedisi, zonat të prirura ndaj rrezikut dhe degradimit dhe tashëgimia kulturore (5) si dhe kapacitetet njerëzore dhe institucionale në fushën e planifikimit hapësinor (6). Brenda çdo fushe janë të renditura qëllimet dhe objektivat. Nga fushat e lartpërmendura, objektivat nga fusha e dytë - zhvillimi ekonomik është kryesisht i fokusuar në bujqësi dhe industrinë e ndërlidhura – mund të ketë ndikim të rëndësishëm mjedisore nëse nuk zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Objektivat në fushën e tretë (infrastruktura/shërbimet publike) janë të drejtuara kryesisht në qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e situatës aktuale dhe për këtë arsye mbajnë një potencial për ndikime mjaft pozitive mjedisore, për shembull ndërtimi i trotuareve në rrugë, promovimi i transportit të jo-motorizuar, trajtimi i ujërave të zeza, trajtimi i mbeturinave të ngurta. Objektivat nën fushën 4 janë kryesisht të përqendruara në ngritjen e vetedijes rreth planifikimit hapësinor, mbrojtjes dhe përdorimit racional të tokës.

Objektivat nën fushën 5 janë kryesisht të përqendruara në zgjidhjen e problemeve aktuale të mjedisit dhe zbutjen e efekteve nga zhvillimi ekonomik.

Prandaj zbatimi i këtyre objektiveve nuk duhet që të ketë ndikim të rëndësishëm negativ mjedisor. Implementimi i objektiveve në fushën 6 nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, pasi që ato janë të fokusuar vetëm në thelbin administrativ, por efektet të cilat janë jo të drejtpërdrejta janë mjaft pozitive duke pasur parasysh rritjen e kapaciteteve të stafit komunal, bazës së të dhënave e cila është e përditësuar si dhe sistemin e punës për lëshimin e lejeve të ndërtimit janë baza për përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e proceseve të vendimmarrjes të cilat janë themeluar.

Korniza propozon dy skenarë të zhvillimit hapësinor –Skenari Linear dhe Skenari i Koncentruar, që përshkruan skenarët dhe identifikon përparësitë dhe mangësitë përkatëse. Po ashtu është përpunuar një skenar i integruar i cili kombinon skenarin linear dhe atë të koncentruar, prandaj është sugjeruar që ky skenar të jetë një strukturë e përshtatshme për zhvillim në të ardhmen në komunën e Mamushës. Karakteristikat e përbashkëta për të gjithë skenarët e propozuar në përputhje me vizionin dhe objektivat strategjike pasi që toka bujqësore mbrohet nga krijimi i vendbanimeve dhe industrisë janë të rezervuara vetëm për përdorim bujqësor.

Skenari Linear – si të gjithë skenarët e tjerë, rezervon zonën juglindore të komunës për përdorim bujqësor ( me përjashtim të zonave pyjore ekzistuese). Ndikimi mjedisor i përdorimit bujqësor nuk varet nga shtrirja gjeografike por nga intensiteti i zhvillimit të bujqësisë dhe aktiviteteve specifike bujqësore.

Për rastin e Mamushës është kryesisht rritja e domateve, në tokë të hapur por po ashtu edhe në sera. Në mënyrë që të zbuten efektet e rritjes së gjerë të kulturave bujqësore, masat përkatëse bujqësore-mjedisore duhet që të përpunohen dhe zbatohen në mënyrë efikase për një përdorim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të tokës. Pasi që zona bujqësore përfshin dy lumenj, ndikimi i aktiviteteve bujqësore në lumenjë është gjithashtu i rëndësishëm, veçanërisht rreziku i ndotjes nga përdorimi i plehrave. Në këtë skenar nuk ka zona të veçanta të cilat parashikojnë shmangien e zonave bujqësore nga zonat urbane ose korridoret e lumenjve, edhe pse është përmendur rehabilitimi i tyre në përshkrim.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm i paraparë në skenarin linear është zgjerimi i vendbanimeve planifikuar në pjesën perëndimore të komunës. Zona e re dhe e gjerë urbane ka ndikim negativ mjedisorë pasi që do të mbulonte një pjesë me karakteristika natyrore dhe përfshin presion shtesë në shërbimet e ekosistemit, kur të jetë plotësisht e banuar. Nga pikëpamja e mjedisit pikat e forta të skenarit linear janë të përqendruara në vendosjen e zonave industriale dhe shtrirjen e zonave pyjore, kjo e fundit është gjithashtu zonë shmangie në mes të zonës së banuar aktuale dhe zonës së NSH-ve dedikuar për përdorim industrial.

Skenari i koncentruar – skenari i koncentruar nuk parashikon krijimin e zonave urbane krejtësisht të reja dhe të gjera në zonat aktuale natyrore, zhvillimi i zonave urbane është planifikuar nga dendësimi i zonës aktuale urbane. Nga perspektiva që më shumë zona natyrore kanë një ndikim pozitiv mjedisor dhe në rastin e kësaj lloji qasjeje të shërbimeve komunale (menaxhimi i mbeturinave të ngurta, trajtimi i ujërave të zeza etj) të cilat kontribuojnë në cilësinë e mjedisit mund që të organizohen në mënyrë më efektive. Në anën tjetër, duke marrë parasysh situatën aktuale demografike (popullsia e re dhe në rritje) mungesa e zonave urbane shpesh mund të çojë në krijimin e vendbanimeve të paligjshme/paplanifikuara në zonat e rrezikuara. Fakti që nuk ka zona të caktuara industriale të cilat janë të pasqyruara në skenarin e koncentruar do të ketë ndikime pozitive mjedisore, por mund të çojë në situata kur në nevoja jetike për aktivitete industriale mund të vendoset pa procedura të duhura dhe të plota të planifikimit.

Skenari i integruar – ky skenar parashih sigurimin e zonës së vendbanimit në pjesën perëndimore të komunës, por është dukshëm më e vogël se ajo në skenarin linear dhe se skenari i integruar gjithashtu inkurajon dendësimin e zonave urbane aktuale ashtu siç është sugjeruar në skenarin e koncentruar. Kjo qasje është e mundshme për të përmbushur nevojat e komunës për zhvillimin e vendbanimeve pa pasur ndikim të madh në zonat natyrore. Zonat në pjesën juglindore të komunës janë të ruajtura për përdorim bujqësor, ashtu si në skenarët e tjerë. Ekzistojnë zona e pyllëzimit (zona C) dhe për zhvillimin e industrisë së bujqësisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe kultivimit të bimëve (zona D). Ana e fortë e skenarit të integruar është siguri i një korridorit të gjelbër përgjatë lumit, edhe pse nuk ofron ndonjë lidhje të veçantë në mes të zonave të tjera natyrore brenda komunës. Në mënyrë që ndikimet e mundshme të mjedisit të përqendrohen dhe të bëhet kombinimi i masave të mundshme të lehtësimit në zonën industriale konkretisht në atë të shënuar (zona D) është e vendosur së bashku me stacionin transit të mbeturinave të ngurta. PZHK-ja sugjeron që skenari i integruar të jetë një skenar i rekomanduar për përdorimin e tokës për komunën e Mamushës dhe që mund të vlerësohet një bilanc i arsyeshëm në mes të interesave mjedisore dhe ekonomike të gjetura me anë të këtij skenar.

Nga kapitujt e kornizës strategjike dhe hapësinore, pjesët përfundimtare për zbatimin e PZHK-së janë nxjerrë. Karakteri, forca, koha-shkalla dhe fushëveprimi i ndikimeve të mundshme mjedisore nga veprimet e parashikuara/veprimet janë të reflektuara në matricën e mjedisit (Aneksi 5). Matrica pasqyron që nuk ka projekte/veprime me ndikim të madh negativ mjedisor. Ndikim negativ i dobët/moderuar është vlerësuar se mund të ndodhë nëse projektet përfshijnë aktivitete të ndërtimit pasi që ka nevojë për përdorimin e resurseve (p.sh burimet minerale për materialet e ndërtimit). Nëse objektet ndërtohen duke pasur parasysh çështjet e qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të energjisë, ndikimet afatgjata nuk mund të parashikohen. Shumica e projekteve/veprimeve kanë ndikim neutral ose ndikim të dobët pozitiv mjedisor, kjo e fundit është nënkuptuar për planifikim/programimin e aktiviteteve të ndryshme pasi që planifikimi në vetvete nuk shkakton kryerjen e përmirësimeve të planifikuara. Potenciali mjedisor (dhe ndikimet mjedisore të forta) duhet që të realizohen kur të bëhet kryerja e planeve/programeve. Kapitujt e zbatimit në mënyrë efektive adresojnë çështjet kryesore të mjedisit duke propozuar projekte përkatëse me ndikim të fortë pozitiv mjedisor për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe atë natyrale të Mamushës. Gjegjësisht, projekti i zgjerimit dhe rehabilitimit të rrjetit të kanalizimit, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe themelimi i korridorit të gjelbër janë vlerësuar të kenë ndikimin më të fortë pozitiv mjedisor. Përveç projekteve specifike, përmbajtja dhe struktura e kapitujve të implementimit (duke përfshirë kornizën hapësinore) me tregues të qartë të kornizës kohore, financiare dhe organeve përgjegjëse ka të ngjarë që do të përmirësojë cilësinë e jetesës dhe kushtet natyrore të komunës pasi që dokumenti është i orientuar në praktikë dhe ofron bazë solide dhe të qëndrueshme për vendim-marrjet të mëtutjeshme.

## 8.1 VLERËSIMI I ALTERNATIVAVE MJEDISORE

Shqyrtimi i alternativave është një element thelbësor në procesin e VSM-së, në rastin e PZHK-së së Mamushës, dokumenti i planifikimit në vetvete përmban skenarë të ndryshëm të zhvillimit hapësinor, nga të cilët, skenari i preferuar (skenari i integruar) është identifikuar si më i përshtatshmi për zhvillimin e mëtejshëm të komunës. Në kuadër të procesit të VSM-së dhe raportit aktual të VSM-së të gjithë skenarët për zhvillim hapësinor të propozuar nga PZHK-ja janë analizuar më lartë, por përveç kësaj vëmendje e veçantë i u është kushtuar alternativave të mëposhtme mjedisore (të zgjedhura, identifikuar dhe të diskutuara gjatë fazës së studimit të VSM-së):

- Alternativa mos-bëj asgjë. Ndikimet socio-ekonomike dhe mjedisore do të analizohen në kontekstin e mos zbatimit të PZHK-së, aspektet pozitive dhe negative të gjendjes aktuale do të përshkruhen dhe analizohen, zhvillimet e mundshme të tendencave në të ardhmen pa ndërhyrje duhet të parashikohen.

- Alternativa e preferuar në PZHK (skenari i integruar), aspektet pozitive dhe negative të skenarit të integruar do të përshkruhen dhe analizohen, zhvillimet e mundshme të tendencave në të ardhmen do të parashikohen.
- Alternativa e kombinuar (elementet e skenarit të integruar dhe linear nga PZHK-ja, elementet shtesë), një alternativë e kombinuar me elemente nga skenari i integruar dhe linear i PZHK-së si dhe elemente të tjera shtesë (zonat mbrojtëse, zonat e përqendruara industriale).

Vlerësimi mjedisor i kapitujve të PZHK-së është kryer paralelisht me pjesën përbërëse të draft kapitujve të vlerësimit paraprak të skenarëve të PZHK-së e cila u zhvillua menjëherë pas hartimit të kornizës hapësinore.

Drafti i parë në kapitullin e zhvillimit hapësinor është sugjeruar që të përmirësohet sipas të të njëjtave karakteristika të cilat ishin përfshirë në përshkrimin e skenarit të tretë mjedisor.

Pasi që janë miratuar, pranuar dhe integruar në draftin e plotë, në PZHK nuk ka pasur dallime të mëdha në mes të skenarit të dytë dhe të tretë pasi që shumica e sugjerimeve të vlerësimit mjedisor janë përfshirë në mënyrë efektive në skenarin e preferuar në PZHK:

- Një zonë e përqendruar industriale (siç është në skenarin linear brenda tokës së NSH-ve me zonën e shmangies të pyllëzuar në mënyrën e duhur) ka të ngjarë që të kenë ndikim të duhur mjedisor nëse ato të dyja vendosen në mënyrë të ndarë. Zonat tampon (100m sipas kapitullit përshkruar) nga zonat natyrore/rezidenciale ose masa të tjera lehtësuese mund që të jenë krijuar në mënyrë më efektive dhe kosto për të siguruar infrastrukturën e nevojshme mund të ishte më e ulët;
- Lokacioni paraprak ose lokacionet alternative për stacion transit të mbeturinave të ngurra duhet që të sugjerohen në PZHK, pasi përzgjedhja e këtij vendi duhet që të jetë në përputhje me zhvillimet tjera hapësinore dhe duhet që të merret parasysh opinionimi publik, shëndeti dhe siguria, distanca e transportit, qasja, klima, drenazh dhe ekonomia. Një alternativë është sugjerimi i këtij lokacioni në zonën industriale pasi që prodhimi i mbeturinave (të rrezikshme) nga industria mund të parashikohet dhe çështjet e qasjes mund që të trajtohen së bashku;
- Lumenjtë Toplluha dhe Trrnja, janë të përdorur brenda një zone bujqësore e cila është e përdorur gjerësisht, prandaj rehabilitimit i lumenjve dhe krijimi i një pjese të korridorit të gjerbët përgjatë lumit Toplluha është paraparë në PZHK. Në mënyrë që të sigurohet një rritje më e madhe, sigurohet ruajtja e biodiversitetit (shtretërit e lumenjve kanë dëshmuar që të kenë potencial të lartë të biodiverzitetit, për shkak të shfaqjes së buzë-efektit) dhe lehtësimi i ndikimit bujqësor në zonën e shmangies përgjatë të gjithë shtretërve të lumenjve brenda Mamushës që është e gjerë sa 25 metra (përveç zonës së detyrueshme që kërkohet nga Ligji për Ujërat në Kosovë, Neni 47) nga kufiri i ujit mund të themelohet dhe pasqyrohet në hartën e skenarit;
- Kapitulli i energjisë adreson vetëm çështjen e energjisë elektrike, sugjerimet lidhur masave të efikasitetit së energjisë (sa i përket ngrohjes së shtëpive dhe po ashtu serave) duhet që të analizohet ose rekomandohen që të adresohen brenda PZHU-së;
- PZHK-ja lejon ndërtimin e ndërtesave të larta deri në tre kat në të gjitha njësitë e propozuara të planifikimit, dhe niveli minimal i dy kateve është përcaktuar për zonat A,B dhe C. Marrëveshja për zonat A, B, dhe C lejon dendësim efektiv dhe është në përputhje me trendët aktuale të vendbanimeve në zonën urbane në Mamushë. Pasi që zona D është një zonë e re e propozuar për vendbanim dhe e cila është e kufizuar me zona natyrore/bujqësore duhet që të merret parasysh një dendësi më e ulët e banimit (me lartësi prej 1-2 kate). Në këtë mënyrë një zonë e re e vendbanimit kryen funksionin e një zone transite në mes që qendrës urbane dhe zonës rurale dhe përfshin ndikim më të ulët në shërbimet mjedisore dhe në karakter të ndryshëm hapësinor urban ofron jetesë cilësore alternative/më të lartë. Kërkesat më specifike hapësinore për zonat urbane (kufizimet në lartësi, madhësia minimale e ngastrës së tokës, zonat jeshile etj) duhet që të adresohen brenda PZHU-së;
- Në të ardhmen përdorimi i kërkuar i zonave të NSH-ve duhet që të shënohet më qartë ose alternativat e sugjeruara duhet që të prioritizohen.

Ndikimet e mundshme të skenarit mos bëj asgjë: nën skenarin mos bëj asgjë i cili do të rezultonte në qoftë se nuk ka aktivitete strategjike të planifikuara, Mamusha do të mbajë karakteristikat e saj aktuale fizike, mjedisore dhe socio-ekonomike. Zhvillimi do të ishte i kufizuar dhe kryesisht i varur nga tregu. Investimet në të ardhmen nga Komuna e Mamushës dhe të tjerët (privatë, kombëtar, donatorë) do të mungonin nëse nuk ofrohet plani zhvillimor dhe roli i Komunës së Mamushës si një ndikues pro-aktiv në këtë zonë do të humbej. Miratimi i skenarit mos bëj asgjë do të thotë që Mamusha do të mbetet e nën shfrytëzuar me rritje të kufizuar fizike, sociale ose ekonomike. Ndikimet e tjera negative që ndërliidhen me zgjerimin e parregulluar të vendbanimit krijojnë bllokime në trafik, ndotje nga zhurma dhe

aksidente në trafik. Një masë e madhe e tokës së urbanizuar rezulton në humbjen e tokës bujqësore, rekreative dhe natyrore. Vendbanimi qendror do të vuajë nga rritja dhe zhvillimi i pa planifikuar. Në anën tjetër, gjendja socio-ekonomike dhe mjedisore e zonave rurale mund të përkeqësohet në mënyrë të konsiderueshme nëse sigurimi i shërbimeve publike dhe mundësive të punësimit ulet dhe se projektet e propozuara rreth qëndrueshmërisë nuk do të zbatohen. Pasi që në thelb PZHK-ja e Mamushës ka në shënjestër zgjidhjen e çështjeve aktuale mjedisore dhe nxitjen e zhvillimit të vazhdueshëm dhe qëndrueshëm dhe përfshin vetëm disa projekt-propozime në fushën e ndërtimit të cilat mund të (nëse nuk është planifikuar, përgatitur dhe zbatuar në mënyrë të arsyeshme) përfshijë disa ndikime mjedisore të dobëta dhe afat-shkurtra, skenari mos bëj asgjë nuk mund të konsiderohet si skenar i preferuar.

Alternativa e preferuar në PZHK (skenari i integruar) Në mënyrë që të përdoret infrastruktura ekzistuese dhe të përdoret toka në mënyrë racionale, koncepti inkurajon dendësimin aty ku është e mundur, gjithashtu ofron hapësirë për vendbanime të tjera në të ardhmen, ndërsa infrastruktura sociale dhe administrata do të mbeten në qendër të qytetit, përdorimi i përzier do të zhvillohet me zonën ekzistuese urbane në veçanti përgjatë rrugëve. UN-Habitat (2012) thekson se: „politikat për përdorim të përzier të tokës shkurtojnë distancën deri në punë. Transporti në qendra të punësimit, mund të jetë i kushtueshëm dhe mund të imponojë një taksë të rëndë për familjet që marrin paga minimale. Miratimi i standardeve të zonave të përziera ka për tendencë që të sjellë së bashku punët dhe shërbimet në mënyrë që të zvogëloj nevojën për të udhëtuar. Ky skenar përfshin densifikimin e vendbanimit aktual, sipas UN-Habitat (2012) „densiteti i lartë ndihmon për të arritur ekonomitë e shkallës ashtu si në infrastrukturë edhe në impiante të trajtimit të tilla si ato që merren me trajtimin e ujërave të zeza. Shpenzimet e ulëta për familje mund të kalojnë tek banorët dhe se ngarkesa e borxhit më të ulët ndihmon në sigurimin e stabilitetit fiskal. Densiteti më i lartë i mundëson një qyteti që të futë ngrohjen qendrore dhe sistemin e ftohjes, pasi që mund të i shërbejnë më shumë konsumatorëve.“. Koncepti rekomandon krijimin e zonave natyrore të shmangies në mes të zonave industriale dhe atyre të vendbanimeve, zona e shmangies përgjatë shtratit të lumit në mënyrë që të lehtësojë ndikimin e aktiviteteve bujqësore për biodiversitetin e lumit, si dhe trotuareve në mënyrë që të krijojë një lidhje në mes zonave të ndryshme të komunës. Po ashtu koncepti sugjeron lokacionin transit për mbeturinat e ngurta ose qendrën e riciklimit në një vend ku do të zhvillohet industria. Përparësi e skenarit është pyllëzimi si masë mbrojtëse nga erozioni, përdorimi racional i tokës përmes dendësimit, inkurajimi i përdorimit të mjeteve jo-motorike për transport si dhe rritja e mundësive për sigurimin e transportit publik. PZHK-ja thekson se ky është skenar i preferuar për shkak se themelon një bazë për zhvillimin hapësinor të mëtejshëm të komunës. Pasi që ky skenar brenda draftit final të PZHK-së tashmë është ndryshuar me karakteristika shtesë nga skenari i tretë mjedisor.

## 8.2 MASAT LEHTËSUESE

Objektivi dhe qëllimi i masave lehtësuese është shmangia ose ulja e ndikimit të mundshëm negativ në mjedis.

Zgjedhja e masave më të përshtatshme lehtësuese është një proces i vazhdueshëm gjatë tërë periudhës së zhvillimit dhe duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë të të gjithë akterëve relevantë (vendimmarrësit, ekspertët, investitorët, banorët lokalë, OJQ-të). Masa e përshtatshme lehtësuese duhet të jetë më e mira në mesin e alternativave të mundshme dhe duhet t'i marrë parasysh edhe aspektet ekonomike.

Edhe pse gjatë fazës së vlerësimit nuk janë identifikuar ndikimet më të mëdha negative, ende ekziston nevoja për shmangien ose zvogëlimin e efekteve të mundshme negative që mund t'i kenë disa prej aktiviteteve të PZHK:

- gjatë planifikimit dhe krijimit të zonave të reja industriale, zgjerimit të vendbanimeve ose infrastrukturës ekzistonte nevoja për gjetjen e një bilanci në mes të interesit socio-ekonomik dhe mjedisor duke planifikuar korridore të gjelbëra, zona e shmangies, promovim dhe zbatim të zgjidhjeve të qëndrueshme të energjisë etj, përgjatë aktiviteteve zhvillimore një vlerë maksimale e zonave ekzistuese të gjelbra duhet që të ruhet, në Mamushë duhet që të i jepet vëmendje e veçantë zonave të pyllëzuara;

- menaxhimi i burimeve ekzistuese pyjore duhet që të jenë veçanërisht i qëndrueshëm për të siguruar biodiversitetin pyjor dhe përfitimet afat-gjata ekonomike të menaxhimit të qëndrueshëm pyjor;

- gjatë planifikimit dhe krijimit të objekteve rekreative, aktiviteteve të përshtatshme duhet që të zgjidhen në bazë të kapaciteteve të zonës; lëvizshmëria e vizitorëve duhet që të kanalizohet në mënyrë të përshtatshme (me rrugë për kalimtarë, vende për parkim, tualete, vende pushimi) në mënyrë që të rritet shfrytëzimi i peizazheve të vlefshme dhe zonave natyrore (d.m.th korridoret e lumenjve në Mamushë) të propozuara nga planet e menaxhimit.

- gjatë planifikimit dhe krijimit të zonave industriale ekziston nevoja për rezervimin e hapësirave sanitare dhe zonave të shmangies në mënyrë që të mos vendosen në një vend jo të përshtatshëm (niveli i lartë i zhurmës, ndërtesave masive, transportit intensiv) objektet industriale në afërsi të vendbanimeve dhe zonave me vlerë të lartë natyrore / piktoreske.
- gjatë planifikimit dhe krijimit të ndërtesave publike, parimet e efikasitetit të energjisë duhet që të zbatohen në mënyrë efektive për të siguruar ndërtimin e qëndrueshëm, si dhe mirëmbajtjen e mëtejshme. Përveç ndikimit pozitiv të drejtpërdrejtë nga sektori i qëndrueshëm i ndërtesave publike ka një rol shembullor për të nxitur ndërtimin efikas të energjisë dhe zgjidhjet e mirëmbajtjes për sektorin privat gjithashtu.

### 8.3 PËRFUNDIM

Procesi strategjik i vlerësimit mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Mamushës përfshinë një gamë të gjerë të qëllimeve nga (Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit) për shumë vende (zgjerimi i vendbanimeve lokale, mbrojtja e tokës tradicionale bujqësore – përdorimi).

Megjithëse plani është planifikuar dhe do të zbatohet në nivel lokal, ky plan do të ketë pjesën e vet që do të kontribuojë në Kosovë, Evropë, dhe përpjekjet e botës për trajtimin e një sërë sfidash komplekse mjedisore të tilla si ndryshimi i klimës, humbja e biodiversitetit dhe ndotja. Autoritetet komunale të Mamushës së bashku me hartuesit e planit dhe palët e përfshira janë ballafaquar me këtë sfidë me sukses dhe dokumenti i përgatitur i planifikimit krijon një bazë të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të qëndrueshëm që korrespondon edhe me planet dhe programet e nivelit të lartë. Duke qenë dokumenti i parë i planifikimit hapësinor për komunën e themeluar rishtas, i jep një drejtim për zhvillimet e mëtejshme të planifikimit hapësinor. Prandaj fakti që plani është bërë në mënyrë pjesëmarrëse dhe se ka një orientim shumë real dhe të zbatueshëm krijon një bazë të mirë për zbatimin e mëtejshëm efektiv të planit. Pasi që është e qartë nga vetë PZHK-ja dhe nga raporti aktual i VSM-së që situata aktuale ka nevojë për përmirësime ekonomike dhe mjedisore, potenciali zbatues është një karakteristik thelbësore e planit. Pjesët strategjike, hapësinore dhe zbatuese të dokumentit të planifikimit janë të bazuara në të dhënat e mbledhura (p.sh anketa familjare ) dhe analiza adekuate. Çështjet e qëndrueshmërisë të cilat janë të përfshira si politika prioritare në strategjinë e zonës-objektivat, dispozitat zbatuese rrjedhin në përputhje me rrethanat.

Pasi që plani i zhvillimit është i drejtuar në përgjithësi në përmirësimin e situatës aktuale, ekonomike si dhe mjedisore, mund të arrihet në përfundim në përputhje me matricën e mjedisit, se zbatimi i këtij plani nuk do të përfshijë ndikime të rëndësishme negative mjedisore. Ky plan trajton në mënyrë adekuate sfidat kryesore mjedisore në Mamushë të tilla si: balancimi i përdorimit të tokës, problemet me bujqësi të qëndrueshme dhe të ndotjes. Në mënyrë që të zbatohet në mënyrë efektive zhvillimi në përputhje me parimet e qëndrueshme, raporti aktual i VSM-së propozon një serë objektivash mjedisore, treguesish si dhe qëllimet, të cilat janë të nxjerra nga PHZK-ja dhe janë në përputhje me parimet moderne të zhvillimit të qëndrueshëm dhe planet dhe programet e nivelit të lartë. Këto objektiva duhet që të zbatohen, monitorohen dhe korrigjohen (të gjetura si të mundshme dhe të nevojshme) paralelisht me PZHK-në aktuale.

Gjatë fazës së studimit të VSM-së aktuale është propozuar që tre skenarët mjedisor duhet që të vlerësohen dhe analizohen gjatë procesit të VSM-së. Pasi që procedura e planifikimit të VSM-së është kryer në mënyrë paralele, karakteristikat kryesore (sugjerimet për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, masat lehtësuese) tashmë janë përfshirë në skenarin e preferuar brenda VSM-së. Prandaj skenari i PZHK-së është ri-vlerësuar në kuadër të raportit të VSM-së dhe është konstatuar që i plotëson kriteret e përfshira paraprakisht në alternativën e tretë të mjedisit. Prandaj mund të arrihet në përfundim që është në përputhje me parimet e qëndrueshmërisë në qoftë se skenari i preferuar i PZHK-së do të zbatohet së bashku me masat lehtësuese të propozuara dhe procesin e vazhdueshëm të monitorimit.



## IX. MONITORIMI

Si pjesë e procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, masat e parapara për monitorimin e efektit të mundshëm të rëndësishëm të implementimit të PZHK-së së Mamushës janë përfshirë në raportin e VSM-së. Qëllimi kryesor i monitorimit të rregullt është identifikimi i efekteve të mundshme negative të implementimit të PZHK-së sa më herët që është e mundur si dhe nënkuptimi i mjeteve të nevojshme për të parandaluar dhe /ose zbutur ndikimet negative.

Qëllimi i sugjerimeve të monitorimit është që të ofrojë mbështetje për autoritetin përgjegjës (Komuna e Mamushës) për të vlerësuar ndryshimet në mjedisin natyror gjatë zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal të Mamushës. Gjatë monitorimit, duhet që të ekzistojë mundësia për të gjetur synimet strategjike, dispozitat zbatuese etj të planit i cili ka shkaktuar rezultatet apo përmirësimet e pritura.

Një komponent thelbësor i monitorimit të VSM-së është që në mënyrë periodike të vëzhgojë progresin e arritjes së objektivave mjedisore, duke arritur caqet e përcaktuara. Një listë e tregueseve mjedisore dhe qëllimeve është dhënë në Kapitullin 6. Ato janë nxjerrë nga njohja e çështjeve ekzistuese mjedisore brenda zonës së Mamushës si dhe nga legjislacioni, udhëzimet dhe dokumentet e tjera relevante. Është sugjeruar që monitorimi do të kryhet në baza vjetore në takt me procesin e monitorimit të vetë PZHK-së së Mamushës.

Gjatë përgatitjes së raportit aktual të VSM-së, shumica e të dhënave sasiore të mjedisit (uji, ajri, cilësia e tokës etj) është e kufizuar për Kosovën në përgjithësi e gjithashtu edhe për zonën e Mamushës. Prandaj shumica e qëllimeve pasqyrojnë raportin e përmirësimit (në përqindje) të kushteve mjedisore si dhe procesit të monitorimit për arritjen e synimeve do të vlerësohet gjithashtu deri sa të themelohet sistemi i monitorimit. Është sugjeruar gjithashtu se gjatë procesit të monitorimit të qëndrueshëm dhe adekuat të tregueseve /objektivat të propozuar do të vlerësohen dhe do të korrigjohen nëse ekziston nevoja dhe/ose mundësia. Në qoftë se ndodh që rezultatet e monitorimit tregojnë përmbushjen e ndonjë objektivit, duhet që të diskutohet nëse ekziston nevoja dhe domosdoshmëria për ngritjen e qëllimit. Deri sa sistemi i monitorimit për grumbullimin e të dhënave mjedisore (ndotja e ujit etj) nuk është ngritur, monitorimi i disa nga objektivave mjedisore duhet të bëhet në bazë vlerësuese, duke vlerësuar shkallën e ndikimit të një projekti të caktuar (p.sh ndërtimi i objektit për trajtimin e ujërave të zeza) mbi mjedisin (cilësia e ujit).

Përveç monitorimit të objektivave specifike të mjedisit dhe qëllimeve duke matur treguesit e aspekteve mjedisore duhet që të merret parasysh ndërsa vlerësimi i procesit të implementimit të vetë planit. Kjo lejon identifikimin e ndikimeve reale mjedisore të projekteve të zbatuara dhe propozon masa lehtësuese shtesë të sugjerimeve për korrigjimin e planit nëse është e nevojshme. Vëmendje e veçantë duhet që ti kushtohet projekteve të zbatuara nëse matrica e vlerësimit në Aneksin 5 ka treguar që projekti ka pasur ndikim pozitiv ose negativ mjedisor. Në të dyja rastet niveli i ndikimit të projektit ose aktiviteteve të zbatuar duhet që të matet ose vlerësohet. Në rast se ka projekte të reja apo aktivitete shtesë në plan gjatë monitorimit të tij, perspektiva mjedisore dhe ndikimet e tjera duhet që të vlerësohen duke ndjekur shembullin e matricës së dhënë në raportin aktual.

## X. REFERENCAT

### Literatura:

Komisioni Evropian (2010). *Komunikatë nga Komisioni Evropa 2020. Një strategji për rritje të mençur, qëndrueshme, dhe gjithëpërfshirëse* COM(2010) 2020 përfundimtar. Bruksel.

[WWW dokument] URL: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>

Udhëzimet DAC dhe Seria e Referencave „Aplikimi i Strategjive Vlerësuese Mjedisore“. Praktikë e mirë udhëzuese për zhvillimin e bashkëpunimit. OECD 2006

Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). *Vlerësimi Strategjik Mjedisor: libër i të dhënave dhe udhëzues rreth përvojës ndërkombëtare*. Earthscan, SHBA

Kammen, M. D., Mozafari, M dhe Prull, D. (2012). *Renewable & Appropriate Energy Laboratory Energy & Resources Group*, Universiteti i Kalifornisë, Një analizë e burimeve në dispozicion dhe kosto. Berkeley  
[WWW document] URL: <http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>

Marsden, S. (2008). *Vlerësimi Strategjik Mjedisor në Ligjin Ndërkombëtar dhe Evropian*. Earthscan, SHBA

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2011). *Strategjia mbi Menaxhimin e Mbeturinave 2011-2020*. Prishtinë, 2011

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit (2011). *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 – 2020*. Prishtinë.

Nushi, L. (2011). *Përmirësimet për Sistemin e Planifikimit të Kosovës . Capstone Project*. Punimi i Masterit, AUK & RIT.  
[WWW dokument] URL: [https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13686/LuanNushi\\_CapstoneProject\\_Report\\_5-06-2011.pdf?sequence=6](https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13686/LuanNushi_CapstoneProject_Report_5-06-2011.pdf?sequence=6)

Shkolla e Biznesit, Ekonomisë dhe Juridikut. Universiteti i Gothenburg. Departamenti i Ekonomisë Njësia e Ekonomisë Mjedisore. (2008). *Analizë e Mjedisit dhe Klimës në Kosovë* . [WWW document] URL: <http://www.sida.se/Global/Countries%20and%20regions/Europe%20incl.%20Central%20Asia/Kosovo/Environmental%20policy%20brief%20Kosovo.pdf>

Qendra Mjedisore Rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore, REC. (2000). *Analiza Strategjike Mjedisore e Kosovës*. Zyra e REC në Kosovë, Prishtinë. [WWW dokument] URL: <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>

Therivel, R.; Wilson, E.; Thompson, S.; Heaney, D.dhe D. Pritchard (1992) . *Vlerësimi Strategjik Mjedisor*. Londër, Earthscan.

Tofaj, F., Gashi, L., Jaha, T., Toska, E., Bakija, D.(2010). *A është Juniku unik? Devising planning policy documents “in-house”* REAL CORP 2010 Proceedings/Tagungsband. [WWW dokument] URL: [http://www.corp.at/archive/CORP2010\\_87.pdf](http://www.corp.at/archive/CORP2010_87.pdf)

Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën. (2008) *Planifikimi Hapësinor. Instrumenti Kyç për Zhvillim dhe Qeverisje Efektive* [WWW dokument] URL: [http://www.unece.org/fileadmin/DAM/hlm/documents/Publications/spatial\\_planning.e.pdf](http://www.unece.org/fileadmin/DAM/hlm/documents/Publications/spatial_planning.e.pdf)

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2000). *Deklarata e Mileniumit e Kombeve të Bashkuara*

[WWW dokument] URL: <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.pdf>

UN-Habitat (2012). Planifikimi Urban për Udhëheqësit e Qytetit.

[WWW dokument] URL: <http://www.unhabitat.org/pmss/listItemDetails.aspx?publicationID=3385>

Banka Botërore (2012). *Analizë Mjedisore e Shtetit të Kosovës. Vlerësimi i Kostos nga Degradimi Mjedisor, Rishikimi Institucional dhe Shqyrtimi i Shpenzimeve Mjedisore Publike.*

[WWW dokument] URL: <http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA.pdf>

#### Aktet Ligjore:

Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit SEA. [WWW dokument] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT>

Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit të Habitatit 1992. [WWW dokument] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992L0043:EN:NOT>

Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit për Kornizën e Ujit 2000. [WWW dokument] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0060:EN:NOT>

Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998. [WWW dokument] URL: <http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Konventa UNECE për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në një Kontekst Ndërkufitar (Konventa Espoo), 1991. [WWW dokument] URL: [http://www.unece.org/env/eia/about/eia\\_text.html](http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html)

Konventa UNECE mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Konventën për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekst Ndërkufitar (Konventa Kiev ), 2003. [WWW dokument] URL: [http://www.unece.org/env/eia/about/sea\\_text.html](http://www.unece.org/env/eia/about/sea_text.html)

Ligji i Kosovës mbi Planifikimin Hapësinor. [WWW dokument] URL: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003\\_14\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf)

Ligji i Kosovës mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor. [WWW dokument] URL: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf>

## **XI. ANEKSET**

- 1) RAPORTI I STUDIMIT PËR PZHK-në e MAMUSHËS
- 2) RISHIKIMI I LITERATURËS PËR PZHK-në e MAMUSHËS
- 3) METODOLOGJIA PËR PZHK-në e MAMUSHËS
- 4) LISTA E DOKUMENTEVE LEGJISLATIVE TË BE-së PËR CËSHTJET PËRKATËSE MBI MJEDISIN NË KOSOVË
- 5) MATRICA E MJEDISIT

